

28.08.2017 NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtarit Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në lëndën penale kundër të akuzuarëve [REDACTED] nga [REDACTED] rr." [REDACTED]", për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 të KPRK-së dhe [REDACTED] nga [REDACTED] rr." [REDACTED]", për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1358-4/14 të datës 12.01.2015, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 09.02.2016 në prani të prokurorit të shtetit Visar Musa, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

KUNDËR:

I. Të akuzuarit [REDACTED] nga [REDACTED] rr." [REDACTED]", i lindur me dt. [REDACTED], në të njejtin vend, nga i ati [REDACTED] e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prindë i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike mbrohet në liri.

II. Të akuzuarit [REDACTED] nga [REDACTED] rr." [REDACTED]", i lindur me dt. [REDACTED], në të njejtin vend, nga i ati [REDACTED] e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prindë i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike mbrohet në liri.

JANË FAJTORË

SEPSE:

1. [REDACTED]

Se më dt.28.05.2014 rreth ores 13:30 në rrugën "Vllëzërit Gërvalla" në Feriezaj, pas një konflikti verbal me të dëmtuarin [REDACTED], me q' rast I pandehuri [REDACTED] ka sulmuar fizikisht me grusht në kokë dhe ka rrëzuar në tokë, nga pasojat e ati sulmi I dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje në regjionin e mollzës së anës së majtë të fytyrës, e të cila lëndime rezultojnë me pasoja të përkohshme të shëndetit,-

me të cilën kreu veprën penale lëndim i lehtë trupor nga nen.188 par.1 të KPRK-së.

2. [REDACTED]

Se me dt 28.05.2014 rreth ores 13:30 rrugën "Vllëzërit Gërvalla" në Feriezaj, e ka kanosur seriozisht të dëmtuarin [REDACTED] (Xhaxhain e tij) për shkak të një konteksti pronësor me fjalët "se [REDACTED] të ka goditur e unë të vras", me q' rast kjo kanosje ka shkaktuar shqetësim dhe ankth të madh tek I dëmtuari ,-

me të cilën kreu veprën penale kanosje nga nen.185 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4,14, 17, 41,43,46, 49, 50, 51, 52, dhe 73 të KPRK-së dhe eneve 367,450 të KPPK-së të akuzuarit veç e veç i

G J Y K O N

1.Të akuzarin [REDAKTUAR] me denim në të holla në shumë prej 300 € (treqind) Euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, e njëjta do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet 1(një) ditë burg.

2.Të akuzarin [REDAKTUAR] i caktohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprën tjetër penale.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rr.” [REDAKTUAR], nr. [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari i parë që në emër shpenzimet e procedurës penale të paguaj 20 € si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Obligohet i akuzuari i dytë që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzë PP/II.nr.1358-4/14 të datës 12.01.2015 ka ngarkuar të akuzuarit [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rr.” [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së dhe [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rr.” [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt.26.11.2014 në të cilin gjyqtari ka ftuar të akuzuarit të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor duke e udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 323 parag.2.1,2.2 dhe 2.3 të KPPK-së.

Prokurori i shtetit Visar Musa përsëri edhe në shqyrtimin kryesor të akuzuarëve i ka lexuar aktakuzën dhe pas leximit gjyqtari është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën janë akuzuar dhe të njëjtëve i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë lidhur me veprat penale për të cilat akuzohen.

I akuzuari [REDAKTUAR] nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDACTED] nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Pasi të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka ftuar prokurorin e shtetit për të përmbledhur provat që mbështesin rastin konform nenit 328 par 1 të KPPK-së.

Konform nenit 329 gjykata ka bërë prezentimin e provave që i ka konsideruara të rëndësishme për një gjykim të saktë dhe të drejtë.

Në shqyrtimin gjyqësor i dëmtuari [REDACTED] ka deklaruar se jeton në Ferizaj në rrugën [REDACTED], nr. [REDACTED] dhe ditën për të cilën bëhet fjalë ishte në punë në shkollë dhe me të mbaruar mësimin është kthyer në shtëpinë e tij dhe pasë ndrrimit të rrobave të punës ka ndëgjyjar disa të krisura dhe kur ka dalë jashtë ka vrejtur disa punëtor duke punuar në pjesën e hyrjes tek shtëpia, i ka përshëndet dhe ju ka thënë se ato që ju kanë sjellur të punoni i ka djemë të vllaut dhe ju mundë të punoni në pjesën e hyrjes së anës së djemëve të vllaut e jo edhe në pjesën që i takon atij ku aty ishte djali i vllaut [REDACTED] dhe tre apo katër punëtorë dhe menjëher ka dashtë të kthehet mbrenda në shtëpi të tij dhe posa e ka kapur dorzen e derës së hyrjes i akuzuar [REDACTED] e ka tërhequr për kahu dhe e ka goditur me grusht në kokë dhe ashtu i tërhequr nga [REDACTED] e ka hapur dorzën e derës dhe është futur në koridorin e shtëpisë së tij ku [REDACTED] përsëri i me krejtë fuqinë që kishte e ka goditur në kokë dhe nga goditja që ka marrë është rrëzuar në tokë i alivanosur në ato momente ka arritur edhe djali i [REDACTED] ku edhe e ka tërhequr baba e tij duke i bërë titur mos baba, ka parë se ka ardhur edhe i akuzuari [REDACTED] ku në vend që ti nihmoj që të ngritet në këmbë i njëjti e ka kërcnuar me fjalë "ky të ka godit ndërsa unë kamë për të mbytur", më vonë është ardhur bashkshrtja e tij dhe fëmijët më kanë kapur për krahu dhe kanë thirrur një taksì dhe ka shkuar në polici me të arritur në polici ata më kanë dërguar në qendrën e mjeksis në Ferizaj tek mjeku ku ka bërë të gjitha inqizimet e nevojshme dhe ato më kanë lëshuar udhëzim që të shkoj në spitalin e Prishtinës. Edhe pse të akuzuarit i kam djem të vllaut të njëjtit nuk qëndrojnë mirë me mua dhe nuk kanë kërkar falje asnjëherë andaj i bashkangjitem njëkjes penale dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtit të shpallen fajtor.

Dëshmitari [REDACTED] në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ky posedon firmë private dhe nga [REDACTED] është goditur që ti kryej punët tek ai dhe posa ka filluar punën nga shtëpia e tij ka dalur i dëmtuari dhe i ka pyetur se kush ju ka ftuar që të punoni i njëjti e njofton se i ka ftuar [REDACTED] dhe [REDACTED] e ka kapur për krahu që ta fus brenda dhe i ka thënë se është marre të bisedosh me ta pasi këta janë punëtor të komunës së Hanit të Elezit dhe e ka kapur për krahu dhe e ka shty brenda dhe nuk e ka vrejtur se e ka goditur atë ku kanë vazhduar punën dhe pas gjysmë ore kanë ardhur policia, dëshmitari në vazhdim njofton gjyqtarin dhe prokurorin se oborret e shtëpive të akuzuarve dhe të dëmtuarit ishin të ndara me mure në mes e në kemi filluar punën para hyrjes së shtëpisë së [REDACTED] dhe detyra jon ishte vetëm të bëjmë nivelizimin e nuk kemi dalur në pronën e të dëmtuarit pasi pronat e tyre ishin të ndara me mur.

I akuzuari [REDACTED] në mbrojtjen e tij ka deklaruar se jeton në rrugën "Vëllezërit Gërvalla" dhe aty jeton edhe agja i tij tani në cilësinë e të dëmtuarit ku shtëpitë e banimit i kanë të ngjitura njëra me tjetrën ditën për të cilën bëhet fjalë i dëmtuari qëndronte para hyrjes së shtëpisë së tij dhe kryersi i punëve e ka njoftuar se i dëmtuari u kishte thënë se mos punoni aty se jeni duke punuar në pornën time, është e vërtetë se e ka kapur agjën për krahu dhe e ka futur brenda në shtëpinë e tij i cili ofedonte dhe bërtiste dhe e pranon se e ka shtyer dhe ja ka byllur derën, ndoshta ka mund të rrëzohet dhe të bie në

tok ndërsa nuk pranon se e ka goditur, i vije keq që e ka sjell në situatë të tillë që ta kap për krahu dhe ta fus brenda në shtëpinë e tij.

I akuzuari [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor në mbrojtjen e tij ka deklaruar se ditën për të cilën akuzohet se ju ka kanosur agjës së tij nuk është e vërtetë pasi atë ditë ka qenë në Prishtinë dhe për rastin që kishte ndodhur ishte njoftuar nga antarët e familjes së tij se e kanë kërkuar policia dhe menjëherë vullnetarisht ka shkuar në polici ku në delaratën që ka dhënë atje ju ka thënë se nuk është e vërtetë që agjës i ka thënë "[REDAKTUAR] të ka goditur unë të vras", andaj e njëjti vetëm jo të fajshëm për veprën penale për të cilën akuzohet.

Dëshmitarja [REDAKTUAR] ka deklaruar se të dëmtuarin e ka bashkshort dhe me të njëjtin i ka pesë fëmijë ku të akuzuarit jetojnë afër shtëpisë së saj dhe i ka djem të kunatit dhe e njëjti vetëm shumë keq të flas për shkak të afërsisë që ka me të akuzuarit por me [REDAKTUAR] ka problem që 20 vite kurse me [REDAKTUAR] vetëm kohëve të fundit, ditën për të cilën akuzohet [REDAKTUAR] bashkshorti i saj ka qenë punë deri në ora 13:30 dhe posa u kthye në shtëpi nuk ka pasur problem por më pas ka dëgjuar një zhurmë e cila ishte në katin e dytë të shtëpisë edhe me të zbritur në katin përderishte ka parë bashkshortin e saj [REDAKTUAR] që e kishte kapur [REDAKTUAR] dhe i njëjti e ka goditur me grusht në kokë dhe pa vëditje ka rënë në tokë dhe një goditje që ka marrë kam vërejtur duke i rrjedhur gjak nga goja dhe menjëherë i kam ofruar uj dhe ka filluar të vijë në vete ku e kam kapur për krahu dhe është dalur jashtë dhe e kam ftuar një taksist për ta dërguar në emërgjens dhe kjo është kthyer në shpëtim dhe e ka dërguar vajzën e madhe në emërgjens në Ferizaj ku ato e kanë njoftuar se babai i saj është dërguar në emërgjensën e Prishtinës, krejt kjo që ka ndodhur ditën për të cilën akuzohet të akuzuarit ishte se bashkshorti i saj ju ka thënë mos punoni në pronën time, sa i përket të akuzuarit [REDAKTUAR] betohet se ka qenë edhe ky prezent i cili edhe e ka ofenduar dhe e ka kërcënuar bashkshortin tim dhe mua, dhe atë kur i ka thënë se [REDAKTUAR] të ka rrahur a unë ty do të vras.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit Visar Musa ka deklaruar se pas administrimit të provave e posaçërisht të deponimit të dëshmisë së të dëmtuarit në shqyrtimin e sotëm gjyqësor vërtetohet plotësisht se të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] se i kanë kryer veprat penale veç e veç për të cilat akuzohet ka kryer veprat penale që i vëhet në barrë e kjo u vërtetua edhe pjesërisht nga vetë i akuzuari i parë i cili ka pranuar se e ka kapur për dorë dhe e ka shtyer gjatë dhënjes së mbrojtjes së tij gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka propozuar gjykatës që të njëjtit të shpallë fajtorë dhe të shqiptoi sanksion penal të paraprir me ligj si rrethana rënduese mënyren e kryerjes së veprës penale ndaj antarëve të familjes përkatësisht axhës së tyre i moshuar posgatishmëria për të kërkuar falje afërsia e vendit ku jetojnë dhe saksioni penal të jetë preventivë që në të ardhmen të mos mundë ta përsërisin veprat penale kundër të dëmtuarit.

I dëmtuari [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i bashkangjitet ndekjes penale por nuk ka parashtruar kërkesë-pasurorë-juridike.

I akuzuari [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk është përgjegjës për veprën penale që akuzohet dhe në mungesë të provave i ka propozuar gjykatës ta shpallë të pa fajshëm.

I akuzuari [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk është përgjegjës për veprën penale që akuzohet dhe në mungesë të provave i ka propozuar gjykatës ta shpallë të pa fajshëm.

Gjykata duke u bazuar në nenin 7, 8 dhe nenin 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së vlerësoi provat një nga një dhe të gjitha së bashku si dhe lidhje me provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale dhe në bazë të vlersimit të tillë është provuar se i akuzuari

me dt.28.05.2014 rreth ores 13:30 në rrugën “Vllëzërit Gërvalla” në Feriezaj, pas një konflikti verbal me të dëmtuarin [REDAKTUAR], me q’rast I pandehuri [REDAKTUAR] ka sulmuar fizikisht me grusht në kokë dhe ka rrëzuar në tokë, nga pasojat e ati sulmi i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje në regjionin e mollzës së anës së majtë të fytyrës, e të cila lëndime rezultojnë me pasoja të përkohshme të shëndetit,-

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit [REDAKTUAR] manifestohen të gjithë elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 të KPRK-së.

Edhe i akuzuari [REDAKTUAR] është provuar se me dt. dt 28.05.2014 rreth ores 13:30 rrugën “Vllëzërit Gërvalla” në Feriezaj, e ka kanosur seriozisht të dëmtuarin [REDAKTUAR] (Xhaxhain e tij) për shkak të një konteksti pronësor me fjalët “se [REDAKTUAR] të ka goditur e unë të vras”, me q’rast kjo kanosje ka shkaktuar shqetësim dhe ankth të madh tek i dëmtuari.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit [REDAKTUAR] manifestohen të gjithë elementet e veprës penale kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK-së.

Gjendjen e përshkruar faktike gjykata e vërtetoi në bazë të deponimit të dëshmisë së të dëmtuarit [REDAKTUAR] dëshmitarit [REDAKTUAR] dhe dëshmitarës [REDAKTUAR] dhe pjesërisht nga deponimi i dëshmisës së të akuzuarit të parë [REDAKTUAR] i cili nuk e mohon se e ka kapur për krahu të dëmtuarin dhe e ka shtyrë duke e futur në shtpin e tij ku edhe është rrëzuar, por nga dësia e të dëmtuarit dhe bashkëshortës së të dëmtuarit vërtetohet sei akuzuari i parë e ka goditur me grusht në kokë ku nga goditja edhe është rrëzuar e nuk qëndron fakti se është rrëzuar vetëm me shtyrje nga ana e të akuzuarit [REDAKTUAR]. Gjithashtu gjendjen faktike gjykata pjesërishtë e ka vërtetuar edhe nga vetë mbrojtja e të akuzuarit i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ka kapur për dore që ta shti brenda të dëmtuarin tek shtëpia e tij por nga shtyrja ai është rrëzuar pra nga kjo vërtetohet pjesërisht se i akuzuari e ka kryer veprën penale kurës pjesëve tjera të deponimit të mbrojtjes së tij se nuk e ka goditur me grusht në kokë gjykata nuk i fali besim me që ato ishin të orjentuara drejt ikjes nga përgjegjësia penale.

Gjithashtu edhe i akuzuari [REDAKTUAR] ka deklaruar se nuk i është kanosur të dëmtuarit dhe ka mohuar se ka qenë prezent kur është takuar me [REDAKTUAR] por nga dëshmia e të dëmtuarit dhe dëshmitares vërtetohet se ai ka qenë rezent e kjo vërtetohet edhe nga deklarta e dhën e të akuzuarit [REDAKTUAR] dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj me dt.30.05.2014 ku vetë ka thekësuar se ka qenë prezent kur e ka kapur për dore vllau i tij [REDAKTUAR] të dëmtuarin dhe e ka futur mbrenda kurse në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk ka qenë i pranishëm por ka qenë në Prishtinë dhe ky dekalrim i tij gjykata e sheh si deklarim rreth ikjes nga prgjegjësia penale dhe gjykata nuk e aprovoj një mbojtje të tillë.

Me rastin e matjes se llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e tij në kuptim të nenit 73 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese gjykata i mori sjelljet korete gjatë zhvillimeve të procedurave penale, sinqeritetin e tyre se më parë nuk kanë qenë të gjykuar me aktgjykim dënues të formës së prerë për vepra penale dhe i gjykoj: Të akuzarin [REDAKTUAR] me dënim në të holla në shumë prej 300 € / treqind Euro / të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe të akuzarin [REDAKTUAR] i caktohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 / katër/ muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë

së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale bazën e këtyre rrethanave gjykata i të akuzuarit i shqiptoj dënim me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit duke qenë e bindur se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 par.1 lidhur me par 3.të KPPK-së, i dëmtuari [REDACTED] na Ferizaji rr."Vëllezrit Gërvalla" nr.74, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i akuzuari [REDACTED] që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 20 € si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit

I akuzuari [REDACTED] të paguaj shumën prej 20 € të paushallit gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.46/2015 me datë 09.02.2016

Asistenti

Muedin Rexhepi

Gjyqtari

Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

